



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të paragrafit 13.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018,
Bordi i Federatës miraton këtë:

RREGULLORE NR. #03

PËR

FINANCAT, PROCEDURAT DHE RREGULLAT

VERSIONI 1.6



PËRMBAJTJA

1.	Përkufizimet	2
2.	Qëllimi	2
3.	Puna e Bordit	2
4.	Administrimi	3
5.	Politikat financiare.....	4
6.	Politika e sponsorizimit të Federatës	7
7.	Financat e Klubeve, Trajnerëve e Tenistëve - dhe kërkesat.....	7
8.	Përkrahja e Tenistëve	8
9.	Përkrahja e Klubeve	10
10.	Përkrahja e Trajnerëve	11
11.	Përkrahja e Referëve	11
12.	Përkrahja e Garave.....	12
13.	Politika dhe procedura e rimbursimit të shpenzimeve	13
14.	Pjesëmarrja në konferenca, turne dhe paraqitje ndërkombëtare	14
15.	Puna e Këshillit mbikëqyrës.....	15
16.	Politikat kontabël	15
17.	Çmimoret, shpërbimet dhe tarifat e ndryshme.....	17
18.	Regjistrimi i lojtarëve dhe afatet kalimtare	
19.	Dispozitat përfundimtare dhe të tjera	20



VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	01.10.2019	Bordi / 09.08.2019	-
1.1	01.01.2020	Bordi / 15.01.2020	8.1.b Përfshihet edhe Shqipëria krahas Maqedonisë Veriore 12.4. Ndhima për shpërblimet e turneve individuale adult 17.2. Tarifat për angazhimin e referëve 17.4. Tarifat për angazhimin e selektorëve
1.2.	17.09.2020	Bordi / 17.09.2020	11.3. Përkrahja e referëve në garat Davis/Fed Cup 17.2. Tarifat për angazhimin e referëve
1.3.	21.04.2021	Bordi/ 21.04.2021	17.2. Tarifat për angazhimin e referëve 17.2.3. Mëditjet e referëve nëse turne nuk mbahet 17.4. Tarifat për angazhimet e federatës
1.4	24.03.2022	Bordi/ 23.03.2022	8.5. Tenistët do të gëzojnë përkrahje për pjesëmarrje në turne bazuar në ranglistën e Kosovës në fuqi në javën e fundit para fillimit të turneut. Numri maksimal i tenistëve që përkrahen në bazë të ranglistës për llojet e turneve është e precizuar në pikën 8.10. 8.6. Një tenist i cili nuk është i ranguar në ranglistën e Kosovës ose është i ranguar më ulët në ranglistën e Kosovës mund të kualifikohet për mbulesë në një turne të caktuar vetëm nëse tenisti ka arritur në çerekfinale në single ose gjysmëfinale në double në turnet e nivelit Tennis Europe, ITF Juniors, ITF Futures, ndërsa në turnet e zyrtarë të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut (RZ) vetëm nëse tenisti ka arritur në gjysmëfinale të turneutpërkates. 8.10.1. Tenistët të cilët fitojnë përkrahjen nga federata në bazë të ranglistës së Kosovës, shpenzimet do të heqën në një turne nga federata, në turneun tjetër shpenzimet do të mbulojnë nga vet tenisti për të vazhduar me këtë sistem gjatë tërë vitit. 17.2.1. Nëse angazhimi ditor i tejkalon tetë (8) orë, referit i takon shtesa prej €10 për atë ditë. 17.2.2. Për referët që udhëtojnë më larg se 25km (vajtje-ardhje), federata duhet të paguajë edhe transportin në përputhje me seksionin "Transport" të paragrafit 8.9 të kësaj Rregulloreje. 17.2.3. Nëse turne nuk mbahet për çfarëdo arsyeje, referit i paguhet gjysma e totalit të mëditjes për ditë nëse turne është anuluar një ditë para fillimit të turneut ose në ditën e fillimit të turneut, dhe nuk i paguhet fare mëditja nëse turne anulohet dy ditë më herët para fillimit të turneut. 18. Regjistrimi i Lojtarëve dhe Afatet Kalimtare
1.5	01.06.2022	Bordi/02.06.2022	8.10 Tenistët që marrin përkrahje nga sponsorizimet mbi vlerën 1,000 euro nuk do të gëzojnë përkrahje edhe nga buxheti i FTK-së. 9.5. Klubet të cilat nuk i stimulojnë dhe sjellin tenistët në garat e FTK-së, nuk mund të përfitojnë përkrahje nga federata 10.5 Trajnerët të cilët nuk i stimulojnë dhe sjellin tenistët e tyre në garat e FTK-së, nuk mund të përfitojnë përkrahje nga federata
1.6	06.06.2022	Bordi/05.06.2022	8.11. Ndryshimi i çmimit të përkrahjes me transport;
1.7	18.06.2023	Bordi/18.06.2023	17.3.2. Ndryshim në Bonus për avancim në grupe" nga 500€, në 750 €. 17.3.3. dryshim në Bonus për avancim në grupe" nga 500€, në 750 €.
1.8			5.6.3. Për pagesat mbi 300€ nevojitet edhe aprovimi paraprak i Kryetarit. Pagesat e tjera kërkojnë aprovimin paraprak vetëm të Sekretarit. 5.6.4. Për t'i realizuar pagesat për mallra e shërbime ndaj personave juridikë, duhet: (i) të ekzistojë fatura e rregullt dhe origjinale e lëshuar në emër të Federatës; (ii) mallrat / shërbimet përkatëse të jenë pranuar; si dhe (iii) të ekzistojë kontrata përkatëse nëse fatura është në vlerë mbi €300; 8.1. Tenistët e të dyja gjinive të grupmohave U12, U14, U16, U18 dhe "A", të anëtarësuar në Federatë (që marrin pjesë në turnetë e Federatës), gëzojnë përkrahje për pjesëmarrje në: (a) Turnetë zyrtare Tennis Europe, ITF Juniors dhe WTA/ATP/ITF Pro Tour, dhe (b) Turnetë me rendesi shteteror dhe kombetare me aprovim te FTK si: Albanian Bowl, Turne u Pavarsise etj (c) Nuk ka perkrhaje per tenistet ne turnet shtetore te

			<p>vendeve fqinje.</p> <p>8.6. Një tenist i cili nuk është i ranguar në ranglistën e Kosovës ose është i ranguar më ulët në ranglistën e Kosovës mund të kualifikohet për mbulesë në një turne të caktuar vetëm nëse tenisti ka pasaport të Kosovës dhe paraqitet me flamur të Kosovës në turnet e rajonit (shtetet që kufizohen me Kosovën dhe Bullgaria) nëse ka arritur një fitore në turneun kryesore (main draw). Ndërsa për shtetet jashtë rajonit në turnet Tennis Europe, ITF juniors tour, ITF futures, ITF challenger dhe ATP, nëse tenisit e kalon xhiron e parë në main draw do të përfitojë 40% të mbulimit të shpenzimeve, nëse kalon e xhiron e dytë 60%, dhe nese e kalon QF dhe më lartë do të i mbulohe të gjitha shpenzimet sipas tabelës 8.11</p> <p>8.10. Tenistët që marrin përkrahje nga sponsorizimet fillimisht duhet të i mbyllin avanset e sponsorizimeve sipas rregullave të MKRS të të pasur mundësi të përfitojnë nga buxheti i FTK-së. Kjo për shkak pengesave që mund ti shfaqet buxhetit të FTK-së për shkak të mosmbylljes së sponsorimeve.</p> <p>8.11.1. Largohe si dispozitë</p> <p>8.11.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ndryshime në përkrahje të turneve ITF; -Larohen përkrahjet të fluturimeve për rajon dhe jashtë rajonit; - Ndryshime në përkrahje të fjetës -Ndryshime në përkrahje të ushqimt - Larohet kufizimi në maksimumi 100Eur <p>17.2. Tarifat për angazhimin e referëve</p> <p>17.2.1 Largohe si dispozitë</p> <p>17.4. Mëditjet neto të angazhimeve të FTK-së;</p>
--	--	--	---



1. Përkufizimet

Administrata	Administrata e Federatës me të cilën udhëheq Sekretari
Anëtar	Anëtar i Federatës
Bordi	Bordi Ekzekutiv i Federatës
Federata	Federata e Tenisit e Kosovës
KRTK	Këshilli i Referëve të Tenisit të Kosovës
ITF	Federata Ndërkombëtare e Tenisit
Sekretari	Sekretari i Përgjithshëm i Federatës

2. Qëllimi

- 2.1. Përmes kësaj rregulloreje synohet përmirësimi i planifikimit të aktiviteteve dhe kostove përkatëse, rritja e cilësisë, transparencës dhe shpeshëtisë së raportimit financiar, si dhe bashkëpunimi më i ngushtë i Federatës me anëtarët e saj por edhe me institucionet sportive dhe të qeverisjes qendrore a lokale në vend.
- 2.2. Qëllimet synohen të arrihen përmes rregullimit të: politikave financiare dhe kontabël; shpenzimeve që mbulohen dhe procedura për rimbursim të tyre; çmimoreve për anëtarësi, shërbime të referëve, dhe të tjera; mëditjeve për trajnerë, mjekë, lojtarë dhe selektorë gjatë angazhimit të tyre në reprezentacion apo në angazhimet e tjera në emër të Federatës; kërkesave për auditorët e jashtëm dhe afateve për raportim financiar tek institucionet përkatëse, të tilla si: Ministrinë përkatëse për sport dhe administratë publike, donatorët, Kuvend; politikave dhe procedurave për sponsorizim të Federatës dhe Anëtarëve.

3. Puna e Bordit

- 3.1. Bordi mban mbledhje të rregullta së paku çdo tre (3) muaj. Mbledhjet e Bordit i thërret Kryetari, e në mungesë të tij njëri prej nënkryetarëve ose Sekretari.
- 3.2. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit.
- 3.3. Agjendën e caktojnë Sekretari në bashkëpunim me Kryetarin, ndërkohë që të gjithë anëtarët kanë të drejtë të parashtrajnë tema për trajtim. Dokumentacionin e nevojshëm e përgatitë Administrata, me synimin që i njëjti të dërgohet së paku një javë para takimit.
- 3.4. Kuorimi për të mbajtur mbledhjen, gjegjësisht për të marrë vendime, arrihet kur anëtarët prezent janë mbi 50% e numrit të pozitive në Bord (qofshin ato të plotësuar apo boshe).
- 3.5. Një propozim apo vendim mund të quhet i aprovuar, kur numri i anëtarëve që votojnë pro mocionit është mbi 50% të numrit të pozitive në Bord.



36. Procesverbalet për mbledhjet përgatiten nga Administrata, dhe dërgohen për komente në afat prej shtatë (7) ditësh. Anëtarët kanë tri (3) ditë afat që të bëjnë komente mbi to.
37. Bordi mund të merr vendime edhe jashtë mbledhjeve, pra përmes emailit, dhe për të njëjtën vlejné dispozitat e paragrafit 3.4 dhe 3.5 sipër.

4 Administrimi

41. Vendimet, qofshin ato të Bordit ose të Kryetarit, duhet të shkruhen, nënshkruhen dhe të publikohen jo më vonë se shtatë (7) ditë nga marrja e vendimit.
42. Vendimet e Bordit duhet të kenë vitin (VVVV) pasuar nga numri rendor unik (XX), duke marrë formën VVVV-XX. Vendimet e Kryetarit kanë edhe prapashtesën “K” për të bërë dallimin dhe kanë formatin VVVV-XX-K.
43. Krahas kopjes së shtypur, Administrata duhet të arkivojë të gjitha dokumentat (vendime, fatura, etj.) edhe në formë elektronike në re (cloud) në GoogleDrive.
44. Administrata evidenton edhe listën e pajisjeve të zyres (laptop, printer, etj.) si dhe inventarit të rekuizitave të destinuara për klubet (topa, rrjeta, reketa, etj.), dhe arkivon fletëpranimet kur ato dorëzohen.
45. Kontratat
 - 45.1. Kontratat për pranim donacionesh dhe huamarrjesh i nënshkruan Sekretari, ose Kryetari nëse ashtu kërkohet nga donatori.
 - 45.2. Kontratat i nënshkruan Sekretari, ndërkohë që për kontratat me kosto të përgjithshme mbi 1.000€ ose me kosto të interesit mbi €100, duhet të nënshkruajë edhe Kryetari.
 - 45.3. Në rast se Sekretari ose Kryetari janë vetë donatorë ose huadhënës, kontratën përkatëse do ta nënshkruajë Kryetari, përkatësisht Sekretari.



5. Politikat financiare

- 5.1. Buxhetin e Federatës dhe Planin e Aktiviteteve për një vit të caktuar e përgatitë Bordi dhe të njëjtin e aprovon Kuvendi.
- 5.2. Aktivitetet e parapara duhet të jenë të arsyeshme dhe të arritshme, dhe si parim t'i shërbejnë zhvillimit të tenisit në Kosovë, përparimit të tenistëve kosovarë dhe avancimit të Federatës dhe garave që ajo mbikëqyr.
- 5.3. Buxheti duhet të merr parasysh burimet e financimit si: MKRS, ITF, ETF, KOK, anëtarësia, sponsorët dhe donatorët e ndryshëm.
- 5.4. Shpenzimet e të hyrave nga sponsorët e donatorët duhet të bëhen në përputhje me kushtet e vendosura nga ta (nëse ka).
- 5.5. Federata mund të ketë vetëm një llogari aktive bankare në cilëndo kohë, kufizim ky i imponuar nga Ministria. Ndryshimi i llogarisë bankare duhet reflektuar në Statut, ndërkohë që duhet njoftuar të gjitha palët (Ministrinë, ITF-in, TE-në, etj).
- 5.6. Pagesat e Federatës
 - 5.6.1. Të gjitha pagesat që i bën Federata **duhet** të realizohen përmes transferit bankar. Këto transfere duhet të ekzekutohen përmes e-banking, me përjashtim të rasteve kur realizimi i një transferi të caktuar nuk mundësohet nga banka përkatëse.
 - 5.6.2. Pagesat i realizon Zyrtari Financiar. Në rast se nuk ka Zyrtar Financiar të dedikuar, pagesat i realizon Sekretari.
 - 5.6.3. Për pagesat mbi 300€ nevojitet edhe aprovimi paraprak i Kryetarit. Pagesat e tjera kërkojnë aprovimin paraprak vetëm të Sekretarit.
 - 5.6.4. Për t'i realizuar pagesat për mallra e shërbime ndaj personave juridikë, duhet:
 - (i) të ekzistojë fatura e rregullt dhe origjinale e lëshuar në emër të Federatës;
 - (ii) mallrat / shërbimet përkatëse të jenë pranuar; si dhe
 - (iii) të ekzistojë kontrata përkatëse nëse fatura është në vlerë mbi €300;
 - (iv) Klubet që synojnë ta pranojnë pagesa nga Federata duhet të lëshojnë faturë për to. Kjo vlen edhe për rastet si marrja me qira e fushave nga Federata, apo pjesëmarrja e klubit në Kampionat Ekipor.
 - 5.6.5. Për t'i realizuar pagesat për mallra e shërbime ndaj personave fizikë, duhet:
 - (i) mallrat / shërbimet përkatëse të jenë pranuar; si dhe
 - (ii) të ekzistojë edhe kontrata për furnizimin/shërbimin përkatës;
 - (iii) Federata obligohet të ndal në burim kontributet pensionale dhe tatimit nëtë ardhura personale në përputhje me legjislacionin në fuqi.



- 5.66. Për t'i realizuar pagesat për rimbursim ndaj palëve, duhet përmbushur kërkesat dhe procedurat e parapara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.
- 5.67. Zyrtari Financiar mund të zgjedh që nga pagesat e Federatës ndaj një personi fizik apo juridik të ndal borxhin për tarifën e anëtarësisë apo çfarëdo borxhi tjetër, dhe për të njëjtën ta njoftojë palën.
- 5.7. Pagesat ndaj Federatës
- 5.7.1. Transferi bankar është forma e duhur dhe e parapëlqyer për pagesa ndaj Federatës, dhe duhet përdorur për çdo pagesë ndaj Federatës. Transferi bankar përfshin edhe rastet kur Federata vë në funksion portalin për pagesë online të anëtarësisë përmes kartës së kreditit. Përjashtim mund të bëjnë rastet e parapara me dispozitën 5.7.2të këtij paragrafi.
- 5.7.2. Anëtarësia vjetore në Federatë e lojtarëve, trajnerëve dhe referëve mund të paguhet me para të gatshme tek Zyrtari Financiar (nëse nuk ka atëherë tek Sekretari), Koordinatorin i Garave (nëse ka), ose tek mbikëqyrësi i turneut. Në këto raste:
- (i) zyrtari përkatës i lëshon palës fletëpranim si dëshmi për pranimin e mjeteve dhe mban një kopje për Federatën dhe një kopje për qëllime të veta;
 - (ii) pagesat e mbledhura zyrtari duhet t'i transferojë në llogarinë bankare të Federatës ditën e parë të punës që vijon, së bashku me informacionin e palëve që kanë paguar.
 - (iii) para fillimit të turneut Zyrtari Financiar sigurohet t'i pajisë mbikëqyrësit me fletëpranime të mjaftueshme si dhe listë të lojtarëve (të paraqitur në turne) që ende nuk e kanë paguar anëtarësinë.
 - (iv) Është përgjegjësi e mbikëqyrësit të mos lejojë pjesëmarrje në turne të një lojtari që nuk e paguan anëtarësinë vjetore. Nëse kjo ndodh, vetë zyrtari bëhet përgjegjës për atë pagesë dhe e njëjta do t'i ndalet nga mëditja. Në rast pasigurie apo paqartësie se a duhet paguar dikush, mbikëqyrësi këtë duhet qartësuar me Zyrtarin Financiar.
- 5.7.3. Zyrtari Financiar është i obliguar t'i lëshojë faturë për pagesë të anëtarësisë klubeve, shoqatave anëtare, trajnerëve, dhe referëve në fillim të çdo viti ose me rastin e pagesës nëse kjo ndodh e para. Duhet lëshuar faturë edhe për të gjithë lojtarët të cilët e paguajnë anëtarësinë me transfer bankar.

5.8. Pagesat e tarifës hyrëse për turne

- 5.8.1. Me vendim të Bordit mund të obligohet që pagesa e kotizimit për pjesëmarrje në turne të bëhet online përmes portalit të Federatës.
- 5.8.2. Në këtë rast Federata i bart klubit të gjitha pagesat e arkëtuara për këtë qëllim në ditën e fillimit të turneut, e zvogëluar për ndalesat e parapara me paragrafin 5.6.7 të kësaj rregulloreje (nëse ka).

5.9. Raportimi financiar

- 5.9.1. Raportet periodike të Federatës i përgatitë Administrata. Ato dërgohen sipas afateve dhe tek personat e përcaktuar në vijim:

Raporti	Frekuenca	Pranon	Afati	Publiko
Plani i aktiviteteve	Tremujore	Ministria	30 ditët e para të TM	-
Shpenzimet dhe gjendja financiare	Tremujore	Bordi	20 ditë pas TM	-
Specifikacioni i shpenzimeve	Tremujore	Ministria	10 ditë pas kështit	-
Raporti i detajuar i shpenzimeve	Vjetore	-	20 ditë pas vitit	Po
Raporti Vjetor dhe Pasqyrat financiare draft	Vjetore	Bordi / Kuvendi	45 ditë pas vitit	-
Përmbledhja vjetore	Vjetore	Ministria	45 ditë pas vitit	-
Pasqyrat e audituara financiare	Vjetore	Ministria	60 ditë pas vitit	Po

- 5.9.2. Pasqyrat financiare duhet të auditohen nga njëra nga pesë (5) shtëpitë më të mëdha audituese botërore që veprojnë në Kosovë, në mënyrë që të sigurohet besim sa më i madh mbi pasqyrat.
- 5.9.3. Për qëllime të ITF-it, pasqyrat e audituara financiare duhet të publikohen edhe në gjuhën angleze.
- 5.9.4. Administrata duhet të përgatisë dhe dorëzojë brenda afateve të gjitha raporte e tjera që nevojiten sipas legjislacionit në fuqi, apo edhe me memorandumet e marrëveshjet me Ministrinë, donatorët apo sponsorët përkatës.



6 **Politika e sponsorizimit të Federatës**

- 6.1. Sponsorizimet që siguron Federata do të përdoren vetëm për qëllimin e financimit të aktiviteteve të destinuara të sponsorizimit.
- 6.2. Personi që siguron sponsorizim për Federatën nga personat privatë ose korporatat (me të cilat nuk është person i lidhur), ai/ajo shpërblehet me bruto dhjetë përqind (10%) të shumës së sponsorizuar. Nga shpërblimi bruto duhet ndalur tatimin në të ardhurat personale dhe kontributet pensionale të punëdhënësit / punonjësit dhe çfarëdo ndalesash të tjera të parapara me ligjet në fuqi.
- 6.3. Shpërblimi i paraparë me paragrafin 6.2 do të paguhet pasi mjetet e sponsorizimit të jenë arkëtuar.

7 **Financat e Klubeve, Trajnerëve e Tenistëve - dhe kërkesat**

- 7.1. Klubet duhet të kenë kryesinë, të mbajnë mbledhje dhe zgjedhje të rregullta, dhe të kenë procesverbale të këtyre takimeve.
- 7.2. Klubet duhet të dorëzojnë raportin financiar në Administratë (të hyrat dhe shpenzimet sipas formularit të përgatitur nga Federata) deri në tre muaj pas përfundimit të vitit.

Klubet me të hyra më të larta se €10.000 duhet të dorëzojnë edhe pasqyrat e audituara financiare.
- 7.3. Trajnerët e moshës mbi 18 vjeçare duhet të dëshmojnë pagesën e tatimit në të ardhura personale dhe të kontributeve pensionale, qoftë si të vetëpunësuar apo në kuadër të listës së pagave të një apo më shumë Klubi.



8 Përkrahja e Tenistëve

- 8.1. Tenistët e të dyja gjinive të grupmohave U12, U14, U16, U18 dhe “A”, të anëtarësuar në Federatë (që marrin pjesë në turnetë e Federatës), gëzojnë përkrahje për pjesëmarrje në:
 - (a) Turnetë zyrtare Tennis Europe, ITF Juniors dhe WTA/ATP/ITF Pro Tour,,
 - (b) Turnetë me rëndësi shtetëror dhe kombëtare me aprovim të FTK si: Albanian Bowl, Turneu i Pavarsisë etj
 - (c) Nuk ka përkrahje për tenistet në turnet shtetërore të vendeve fqinje.
- 8.2. Krahas përkrahjes për pjesëmarrje në turnetë sipërpërmendura, për shpresat më të mëdha të vendit të grupmohave U12-U18, Bordi mund të caktojë bursa monetare, të angazhohet për ta kampe jashtë apo brenda vendit me trajnerë eminentë, ose t’i ndihmojë me kostot e fushave / trajnerëve në vend dhe jashtë.
- 8.3. Grantet specifike mund të lejojnë përfshirjen e më shumë tenistëve apo llojeve të shpenzimeve që mbulohen. Për këto raste, Bordi do të nxjerrë vendime dhe kushte të veçanta.
- 8.4. Për një vit kalendarik përkrahja për pjesëmarrje në turne zgjat deri në masën e paraparë me buxhetin e atij viti dhe/ose deri në masën siç e diktojnë financat e atij viti. Nëse mundësitë financiare gjatë atij viti shterren, Administrata është e obliguar t’i njoftojë prindërit, tenistët dhe tërë komunitetin për faktin që tridhjetë (30) ditë pas njoftimit nuk do të ketë më përkrahje për atë vit.
- 8.5. Tenistët do të gëzojnë përkrahje për pjesëmarrje në turne bazuar në ranglistën e Kosovës në fuqi në javën e fundit para fillimit të turneut. Numri maksimal i tenistëve që përkrahen në bazë të ranglistës për llojet e turneve është e precizuar në pikën 8.11.
- 8.6. Një tenist i cili nuk është i ranguar në ranglistën e Kosovës ose është i ranguar më ulët në ranglistën e Kosovës mund të kualifikohet për mbulesë në një turne të caktuar vetëm nëse tenisti ka pasaport të Kosovës dhe paraqitet me flamur të Kosovës në turnet e rajonit (shtetet që kufizohen me Kosovën dhe Bullgaria) nëse ka arritur një fitore në turneun kryesor (main draw). Ndërsa për shtetet jashtë rajonit në turnet Tennis Europe, ITF juniors tour, ITF futures, ITF challenger dhe ATP, nëse tenistët e kalon xhiron e parë në main draw do të përfitojë 40% të mbulimit të shpenzimeve, nëse kalon e xhiron e dytë 60%, dhe nëse kalon QF dhe më lartë do të i mbulohen të gjitha shpenzimet sipas tabelës 8.11
- 8.7. Për të pasur të drejtë në përkrahje sipas pikës 8.11, Tenisti duhet paraprakisht ta ketë njoftuar me email Administratën për udhëtimin, dhe kjo e fundit ta ketë dhënë pëlqimin po ashtu me email.
- 8.8. Afati për t’i dorëzuar kërkesën për rimbursim dhe dëshmitë përkatëse (a) së paku një foto nga aktiviteti dhe (b) faturat, është 10 ditë pasi të ketë përfunduar muaji në të cilin ka filluar turneu. Kërkesat e dorëzuara pas këtij afati NUK do të rimbursohen.



- 8.9. Llojet e shpenzimeve që nuk janë përfshirë në paragrafin 8.11 të këtij neni, përveç nëse nuk vendoset ndryshe nga Bordi, NUK do të mbulohen.
- 8.10. Në rast se federata dërgon national teams në turne bashkë me trajnerin përkatës, atëherë nuk do të pranohen shpenzimet shtesë të shoqëruesve të tjerë.
- 8.11. Tenistët që marrin përkrahje nga sponsorizimet fillimisht duhet të i mbyllin avanset e sponsorizimeve sipas rregullave të MKRS të të pasur mundësi të përfitojnë nga buxheti i FTK-së. Kjo për shkak pengesave që mund ti shfaqet buxhetit të FTK-së për shkak të mosmbylljes së sponsorimeve.



8.12. Tenistëve iu mbulohen shpenzimet sipas tabelës në vijim:

Lloji i turneut	RZ	TE	ITF	ITF Futures
Grupmoshat	U12-U18	U12-U16	U18	A
Nr. i tenistëve (M / F)	3 / 3	3 / 3	3 / 3	3 / 3
Anëtarësia vjetore (psh IPIN)	x	x	x	x
Pjesëmarrja në turne	✓	✓	✓	x
Transporti				
Biletat e autobusit / trenit ¹	✓	✓	✓	✓
Karburanti ¹ (për çdo 0-100km)	€15	€15	€15	€15
Fjetja² (për natë)				
Rajon	≤€50	≤€50	≤€50	≤€50
Jashtë rajonit	≤€70	≤€70	≤€70	≤€70
Ushqim e pije (për ditë)				
Rajon	≤€20	≤€20	≤€20	≤€20
Jashtë rajonit	≤€30	≤€30	≤€30	≤€30
Tjera				
Sigurimi shëndetësor	x	x	x	x
Certifikatat mjekësore	x	x	x	x
Telat / reketat / topat	x	x	x	x

1) Kur tenisti është ende i/e pamposhtur, ose e ka përfunduar ndeshjen pas orës 21:00;

- 8.13. Shoqëruesve (trajnerëve ose prindërve që udhëtojnë me tenistët) iu pranohen shpenzimet e transportit vetëm kur Tenisti nuk i ka mbushur 16 vjet. Shpenzimet e tjera të shoqëruesve (të tilla si ushqimi apo fjetja) nuk rimbursohen.
- 8.14. Nëse Tenisti (ose prindi i tij) keqpërdor përkrahjen dhe/ose paraqet dëshmi e fatura të rrejshme, Bordi mund ta përjashtojë Tenistin përherë ose përkohësisht nga skema përkrahëse.



9. Përkrahja e Klubeve

9.1. Klubet të cilat i përmbushin kushtet e parapara me paragrafin 9.3 të këtij neni, mund të gëzojnë përkrahje nga Federata për pajisje, infrastrukturë apo ndihmesa të tjera përfshirë ato financiare.

9.2. Përkrahja është subjekt i mundësive financiare dhe buxhetit të përgjithshëm, dhe ofrohet sipas tabelës në vijim:

Lloji i ndihmës	Ndihma
Topat	- 4 topa në vit për çdo tenist ¹ (sipas grupmohës) - 48 topa në vit për çdo reprezentues të Kategorisë A (pas garave) - 24 topa në vit për çdo tenist që përfundon vitin si Nr.1 (U12-U18)
Rrjeta për tenis	- 1 rrjetë çdo 3 vjet
Mbajtëse të rrjetës	- 1 strukturë mbajtëse çdo 5 vjet
Rrjeta për mini tenis	- 1 rrjetë në vit për çdo 10 tenistë ¹ Red; ose - 1 rrjetë në çdo 3 vjet.
Infrastrukturë	- Çdo 5 vjet / varësisht mundësive
Reketat ≤25"	- Barabartë nëpër klube, varësisht donacionit nga ITF apo tjetër, me prioritet klubet që nuk kanë marrë radhën e fundit.
Trofetë permanentë	- Maksimum €100 për një trofe permanent të turneut tradicional të kategorisë "A" të Klubit (së paku 5 edicione radhazi).
Pajisjet e tjera	- Varësisht kërkesave individuale e mundësive

1) Numri i tenistëve pjesëmarrës në turnetë e vitit paraparak

9.3. Kushtet e aplikueshme për t'u kualifikuar për përkrahje janë:

- Vërtetimi i regjistrimit si klub pranë komunës përkatëse (jo më e vjetër se 12 muaj);
- Vërtetimi i Administratës Tatimore për kryerjen e obligimeve tatimore;
- Pagesa e anëtarësisë për vitin;
- Pjesëmarrja e tenistëve në turnetë që organizohen nën ombrellën e Federatës;
- Zbatimi i kurrikulës nacionale të Federatës (nëse ka);
- Raportimi i tenistëve të anëtarësuar (që janë stërvitur) deri më 30 qershor dhe deri më 31 tetor të çdo viti, me afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pas këtyre datave;
- Zhvillimi i së paku një aktiviteti masovizues gjatë vitit të kaluar (përfshijë klubet e themeluara gjatë vitit).

9.4. Pajisjet që ofrohen nga Federata në asnjë mënyrë nuk lejohet të shiten për qëllime komerciale apo tjetër, dhe Klubi që e bën këtë do të gjohet me €500 ose vlerën e ndihmës nëse ajo është më e madhe se €500.

9.5. Klubet të cilat nuk i stimulojnë dhe sjellin tenistët në garat e FTK-së, nuk mund të përfitojnë përkrahje nga federata.

9.6. Administrata do të mbajë regjistër të përkrahjeve të Klubeve (por edhe Trajnerëve, Tenistëve apo për Turne), dhe do të sigurojë fletëpranimin e tyre për çdo gjë që dorëzohet.



10. Përkrahja e Trajnerëve

- 10.1. Trajnerët duhet të jenë pjesë e klubeve, dhe të kenë paguar anëtarësinë në Federatë, për t'u përkrahur nga Federata. Çdo kërkesë për përkrahje projektesh apo me rekuizita do të realizohet vetëm përmes klubeve në të cilat ata janë të angazhuar.
- 10.2. Trajnerët do të përkrahen përmes organizimit të seminareve, mbajtjes së kurseve për certifikim apo pjesëmarrjes së tyre në konferenca të trajnerëve.
- 10.3. Përkrahja do të varet nga mundësitë financiare si dhe projektet e parapara me planin për zhvillim të trajnerëve të cilin e harton Trajneri Nacional në bashkëpunim me Këshillin e Trajnerëve.
- 10.4. Parimisht, prioriteti do të përcaktohet sipas radhitjes në vijim:
 - 10.4.1. Trajnerët që zbatojnë kurrikulën e Federatës (nëse ka);
 - 10.4.2. Trajnerët që ofrojnë falas kohën e tyre për projektet e masovizimit të tenisit ose për fëmijë të mundësive të kufizuara fizike apo financiare.
 - 10.4.3. Trajneret e gjinisë femrore;
 - 10.4.4. Trajnerët e emëruar si selektorë / nivel më të lartë të certifikimit;
 - 10.4.5. Vitet e punës si trajner; dhe
 - 10.4.6. Rotacionin e trajnerëve.
- 10.5. Trajnerët të cilët nuk i stimulojnë dhe sjellin tenistët e tyre në garat e FTK-së, nuk mund të përfitojnë përkrahje nga federata.
- 10.6. Federata, me kontratë të rregullt apo periodike, mund të angazhojë trajnerë për qendrat nacionale apo rajonale të tenisit në përputhje me negociatat e zhvilluara dhe vendimet e Bordit.

11. Përkrahja e Referëve

- 11.1. Referët duhet të kenë paguar anëtarësinë në Federatë, për t'u përkrahur nga Federata.
- 11.2. Referët do të përkrahen përmes organizimit të seminareve, mbajtjes së kurseve për certifikim apo pjesëmarrjes së tyre në konferenca të referëve.
- 11.3. Për pjesëmarrjen e referëve në garat botërore të tenisit "Davis/Fed Cup" do të përkrahen financiarisht nga FTK me vlerë fikse prej shtatëdhjetë e pesë euro (75).

- 11.4. Përkrahja do të varet nga mundësitë financiare si dhe projektet e parapara me planin për zhvillim të arbitrave të cilin e harton KRTK në bashkëpunim me Këshillin Profesional.

12. Përkrahja e Garave

- 12.1. Mbajtja e turneve do të mbështetet nga Federata me pajisje dhe në disa raste financiarisht, subjekt kjo e mundësive financiare dhe buxhetit të përgjithshëm.
- 12.2. Për të organizuar turne dhe gëzuar përkrahje, Klubi organizues duhet ta ketë paguar anëtarësinë në Federatë.
- 12.3. Përkrahja e garave bëhet sipas tabelës në vijim:

Grupmosha	Turnetë Individuale	Kampionat Ekipor	Masters
U08 (Kuq) ¹	24 Topa Mbikëqyrësi	-	-
U09 (Portokall) ¹	24 Topa Mbikëqyrësi	-	-
U10 (Gjelbër) ¹	24 Topa Mbikëqyrësi	-	-
U12	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi	-	-
U14	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi -	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi Kupat	3 Topa / lojë Mbikëqyrësi Kupat
U16	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi -	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi Kupat	3 Topa / lojë Mbikëqyrësi Kupat
U18	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi Kupat	3 Topa / lojë Mbikëqyrësi Kupat
A	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi - Referi ³ LiveScore - Fushat ⁴	3 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi Kupat Referi ³ LiveScore Dreka ³ -	3 Topa / lojë Mbikëqyrësi Kupat Referi ³ LiveScore - Fushat
35+	2 Topa / lojë ² Mbikëqyrësi	-	-

1) Numri i topave përgjysmohet nëse numri i tenisistëve pjesëmarrës (M+F) është 12 ose më pak.

2) Numri maksimal i topave që ofrohen është 72.⁵

3) Vetëm për finale. Përfshinë dy (2) referë të licencuar ose ndihmës të linjave.⁵

4) Vetëm për garat e femrave.



5) *Kërkesat minimale për referë / topa për turne / lojë përcaktohen me Rregullore të veçantë mbi turnetë, kampionatet dhe rregullat përkatëse, dhe mbulohen nga organizatori kur nuk përkrahen nga Federata.*

124. Krahas përkrahjeve sipër, për turnetë që kanë së paku katër (4) pjesëmarrës / ekipe, Federata do të ndihmojë organizatorin e turneut edhe me çmimet për shpërblimet monetare të turneve në Kategorinë A, sipas tabelës në vijim:

TURNEU \ VENDI I ZËNË	1	2	3-4	5-8	9-16
Individual (M&F)	€150	€75	€40	-	-
Individuale (F) ²	€300	€150	€50	-	-
Masters (M&F)	€500	€250	€125	€60	-
Çiftet (M&F)	€50	€25	-	-	-
Kampionati Ekipor (M&F)	€500	€250	€125	€50	€30

1) *Vlerat përgjysmohen nëse janë vetëm 4 pjesëmarrës.*

2) *Kur turneun e organizinon FTK.*

13. **Politika dhe procedura e rimbursimit të shpenzimeve**

131. Asnjë faturë nuk duhet kërkuar të lëshohet në emër të Federatës, nëse për të njëjtën nuk është dhënë pëlqimi me email nga Administrata. Kjo përfshin edhe faturat për rimbursime të tilla si faturat e karburanteve.
132. Nëse ndodhin rastet sipas 13.1, atëherë vetë personi që ka kërkuar faturën do të jetë përgjegjës për pagesën e së njëjtës.
133. Faturat për të cilat kërkohet rimbursim për shpenzimet e ndodhura gjatë një muaji të caktuar, duhet dorëzuar tek Zyrtari Financiar më së voni dhjetë (10) ditë pas përfundimit të atij muaji. Nëse nuk dorëzohen brenda këtij afati, ato nuk do të pranohen.
134. Faturat që dorëzohen duhet të jenë origjinale dhe të kenë të bashkangjitur dëshminë e pagesës (faturë fiskale për pagesat me kesh dhe/ose ekstraktin e llogarisë bankare për pagesat përmes transferit / kartelave bankare).

Për shpenzimet në Republikën e Kosovës, fatura (apo paragoni) duhet të jetë në emër të Federatës dhe në të cilën shënohet numri fiskal i Federatës (600316419).

Për shpenzimet incidentale jashtë Kosovës (ushqim, pije, biletë transporti lokal, taksi, etj.) mjafton vetëm fatura fiskale apo paragoni. Për fjetje dhe transportin kryesor, nevojiten edhe faturat.

135. Kërkesës për rimbursim duhet bashkangjitur edhe pëlqimi me shkrim i Federatës për shpenzimin në fjalë, apo vendimi i Federatës për lejesë udhëtimi zyrtar.

136. Për udhëtime zyrtare mbulohen shpenzimet si në vijim:

Kategoria	Ushqim e pije ¹	Fjetje	Transport ²
Zyrtar Rajon	≤€30	✓	✓
Zyrtar Tjera	≤€50	✓	✓
Reprezentues Rajon	≤€30	✓	✓
Reprezentues Tjera	≤€50	✓	✓

1) Vlerat janë për 3 shujta ditore dhe përpjesëtohen nëse ka shujta të mbuluara. Pijet alkoolike nuk përfshihen. Për reprezentuesit mbulohen vetëm ushqimi dhe pijet e shëndetshme.

2) Përfshinë shpenzimet rreth sigurimit të vizave, dhe të tjera të transportit (p.sh. bagazh). Shpenzimet e shkaktuara nga humbja e transportit (p.sh. fluturimeve) për neglizhencë vetanake nuk mbulohen.

14. Pjesëmarrja në konferenca, turne dhe paraqitje ndërkombëtare

14.1. Kur një zyrtar (delegat apo tenist) përfaqëson Federatën, rrjedhimisht shtetin e Kosovës, në gara, konferenca apo çfarëdo evenimenti tjetër, ai duhet:

- (a) Të ketë parasysh se në udhëtim zyrtar NUK është person privat;
- (b) Të tregojë sjellje të hijshme dhe profesionale gjatë gjithë kohës, duke përfaqësuar kështu me dinjitet shtetin dhe Federatën;
- (c) Të vesh uniformën / emblemat e Federatës apo shtetit nëse i janë dhënë, apo veshje formale nëse e njëjta kërkohet nga nikoqiri.

14.2. Duke mos qenë person privat në këtë eveniment, pronësia e fotove dhe materialeve të tjera të siguruar gjatë udhëtimit zyrtar janë pronë e Federatës; dhe ekskluziviteti i lajmit dhe fotove nga ngjarja DUHET t'i takojë Federatës dhe jo profileve personale në rrjetet sociale.

Andaj, fotot dhe materialet e tilla së pari duhet të publikohen në faqet zyrtare të Federatës në rrjetet sociale, dhe më pas mund t'i bëhet shpërndarje (Share) nga profili personal apo Shënim (Tag) i zyrtarit në postimin e Federatës.

14.3. Tenisti reprezentues ka përgjegjësi shtesë për t'u siguruar se i pëmbahet rregullave anti-doping të WADA, dhe mund t'i nënshtrohet testimit në çdo kohë nga zyrtarët e Federatës.

14.4. Para secilit udhëtim zyrtar, Administrata ka për obligim ta hartojë dhe pajisë zyrtarin me formularin e angazhimit. Para se të lejohet udhëtimi, zyrtari përmes nënshkrimit të formularit duhet të konfirmojë se i ka kuptuar dhe i pranon kushtet specifike që burojnë nga dispoziat e këtij neni.



15. Puna e Këshillit mbikëqyrës

- 15.1. Administrata dhe Bordi i Federatës janë të obliguara që Këshillit Mbikëqyrës, por edhe auditorëve të jashtëm / brendshëm, t'i shpalosin të gjitha informacionin dhe dokumentacionin në mënyrën më të sinqertë dhe më të shpejt të mundshme.
- 15.2. Për punën e tyre në Këshill, anëtarëve të Këshillit iu takojnë mëditje apo kompensime siç parashihet me dispozitat e kësaj Rregulloreje, dhe vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet e dispozitave kalimtare.

16. Politikat kontabël

- 16.1. Pasqyrat financiare prezantohen në Euro, valutë kjo ligjore në territorin e Republikës së Kosovës. Periudha vjetore e raportimit përfshin vitin nga 1 janar – 31 dhjetor të atij viti.
- 16.2. Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e parasë së gatshme. Sipas kësaj metode, të hyrat njihen kur ato pranohen ndërkaq shpenzimet njihen kur paguhen e jo kur ndodhin.

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për grantet dhe/ose anëtarësitë në rrjedhën normale të organizatës.

Grantet njihen në pasqyrën e pozicionit fillestar fillimisht si të hyra të shtyera kur ato janë pranuar dhe kur pritet që Federata do të veprojë në përputhje me kushtet e bashkangjitura me to.

Grantet të cilat kompensojnë Federatën për shpenzimet e ndodhura njihen si të hyra në pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike në periudhën në të cilën shpenzimet kanë ndodhur. Grantet të cilat kompensojnë Federatën për kostot e një pasurie njihen në pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike përgjatë jetëgjatësisë së pasurisë.

Grantet që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet tashmë të ndodhura, ose për qëllim të dhënies së mbështetjes së menjëhershme për Federatën pa shpenzime të ndërlidhura, njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

Të hyrat për pagesat e anëtarësive vjetore të referëve, klubeve, trajnerëve, dhe tenistëve, si dhe të hyrat e tjera njihen si të hyra në periudhën në të cilën ato arkëtohen.

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën ato janë paguar. Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit mbi huamarrjet, shpenzimet e interesit për pagesat e vonuara. Këto kosto njihen në pasqyrën e të ardhurave me metodën e interesit efektiv.



163. Shpenzimet e zotuarra kanë të bëjnë me shpenzimet që kanë ndodhur, janë vlerësuar ose për arsye të tjera janë zotuar nga Federata, por të cilat nuk njihen si shpenzime në atë periudhë të raportimit shkaku se nuk janë paguar deri në fund të periudhës së raportimit. Këto duhet të evidentohen dhe shpalosen në pasqyrat financiare.
164. Fondet fillimisht krijohen nga kontributet e anëtarëve të bëra në para dhe / ose në natyrë, dhe pasuritë e bartura me vlerat e tyre të drejta. Më pas, fondet rriten / ulen përmes kontributeve shtesë të anëtarëve, dhe rezultatet (teprica / deficit) nga operacionet gjatë periudhave.
165. Transaksionet në valutë të huaj (jo EUR) regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i shlyerjes së transaksioneve në valutë të huaj përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.
- Pasuritë dhe detyrimet monetare në valuta të huaja kthehen në Euro sipas kursit përfundimtar të këmbimit në treg në datën e raportimit të pozicionit financiar. Ndryshimet në vlerën e pasurive dhe detyrimeve në valutë të huaj, që rezultojnë nga ndryshimet në kursin valutor në datën e raportimit, reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si fitim apo humbjeve nga ndryshimet në kursin e këmbimit.
166. Huazimet afatshkurtër paraqesin huamarrjet nga institucionet financiare, individët ose bizneset për qëllime likuiditeti, dhe të cilat maten sipas vlerës së tyre reale në kohën e njohjes fillestare dhe pas njohjes fillestare sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.
167. Për cdo shpenzim, në librin kryesor të kontabilitetit duhet të shënohet: a) Projekti përkatës; b) Burimi/et e financimit; dhe c) kategorinë e shpenzimit.
- Në rast të burimeve të shumëfishta të financimit (donatorëve) bëhet regjistrimi ndaras sipas përqindjeve pjesëmarrëse të donatorëve për atë shpenzim / projekt të caktuar.
- Kategoritë e shpenzimit ndër të tjera përfshijnë: i) Paga e mëditje; ii) Transport; iii) Fjetje dhe akomodim; iv) Ushqim e pije; v) Anëtarësitë vjetore (ITF/TE/KOK); vi) Shpenzime të zyrës dhe bankare; vii) Pajisje, topa dhe rekuizita; dhe të tjera sipas nevojës.
168. Federata nuk bën provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre të paguara pranë Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Kontributet njihen si shpenzim kur paguhen.
169. Si organizatë jo-fitimprurëse, Federata është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave. Njëherësh, Federata nuk është e regjistruar për TVSH.



- 16.10. Pajisjet e Federatës paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e datës së blerjes minus zhvlerësimi i akumuluar pasues dhe humbjet pasuese të akumuluar nga rënia në vlerë e tyre.

Zhvlerësimi njihet në mënyrë që redukton koston apo vlerësimin e mjeteve për vlerat e mbetura mbi jetëgjatësinë e tyre, duke përdorur metodën lineare. Jetëgjatësia, vlera e mbetur dhe metoda zhvlerësimit rishikohen në çdo datë raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësimin e llogaritur në periudhat e ardhshme.

Jetëgjatësia e parashikuar e zërave të pajisjeve janë si më poshtë:

Kompjuterë dhe harduerë të tjerë: 3 vite
Orendi: 5 vite
Automjete: 5 vite

Pasuritë që i nënshkrohen zhvlerësimit kanë kosto blerëse mbi 1,000 EUR dhe jetëgjatësi mbi 12 muaj.

17. Çmimoret, shpërbimet dhe tarifat e ndryshme

- 17.1. Tarifat për anëtarësim në Federatë dhe për pjesëmarrje në turne janë të rregulluara me Rregullore të veçantë.
- 17.2. Tarifat për angazhimin e referëve / ndihmësave janë sipas tabelës në vijim:

Referi / njësia	ROG	U12-U18	TURNEU	
			A	35+
Mbikëqyrësi / ditë	€50	€50	€50	€50
I karrikës / lojë¹				
Xhiro finale	-	€20	€30	€20
Xhirot e tjera	-	€10	€20	€10
I linjave / lojë				
Licencuar	-	€10	€15	€10
Ndihmës	-	€5	€8	€5
LiveScore input / lojë	-	€3	€10	€3
Mbikëqyrësi kryesor në TE/ITF	-	€700	€750	€500
Ndihmës-refer në TE/ITF / ditë	-	€50	€50	€50



- 172.1. Për referët që udhëtojnë më larg se 25km (vajtje-ardhje), federata duhet të paguajë edhe transportin në përputhje me seksionin “Transport” të paragrafit 8.11 të kësaj Rregulloreje.
- 172.2. Nëse turneu nuk mbahet për çfarëdo arsyeje, referit i paguhet gjysma e totalit të mëditjes për ditë nëse turneu është anuluar një ditë para fillimit të turneut ose në ditën e fillimit të turneut, dhe nuk i paguhet fare mëditja nëse turneu anulohet dy ditë më herët para fillimit të turneut.
- 172.3. Nëse për punën apo (mos)praninë e referit / mbikëqyrësit ka ankesa (me shkrim) nga organizatori, prindërit ose komisioneri i garave, dhe të njëjtat miratohen si të bazuara nga Këshilli Disciplinor (ose Bordi), atëherë referi / mbikëqyrësi do të gjobitet me gjysmën e mëditjes / tarifës për atë rast.
- 172.4. Organizatori ka për obligim t’i ofrojë ujë dhe së paku një shujtë mbikëqyrësit të turneut.
173. Pjesëmarrja dhe shpërblimet e përfaqësuesve të Kategorisë “A” në Davis/Fed Cup janë të rregulluara si në vijim:
- 173.1. Premia bazë e tenistëve, për pjesëmarrje, varet nga rankingu i tyre botëror në javën kur mbahen garat.
- 173.2. Premitë për tenistët janë:

LLOJI		PREMIA
Premia bazë		€400-€1,000
Rankingu:	1-100	€1,000
	101-300	€800
	301-500	€600
	501-1,000	€500
	Të tjerët	€400
Bonus për meç të luajtur¹		+€100
Bonus për meç të fituar¹		+€200
Bonus për fitore të ekipit ndaj një shteti		+€100
Bonus për avancim në grupe		+€750

1) Për meçet çift, tenistëve iu ndahet bonusi në dysh.

17.3.3. Premitë për kapitenin e skuadrës janë:

LLOJI	PREMIA
Premia bazë	€400
Bonus për fitore të ekipit ndaj një shteti	+€100
Bonus për avancim në grupe	+€750

17.3.4. Për anëtarët e tjerë të skuadrës caktohen mëditje sipas paragrafit 17.4 ose vendimeve specifike të Bordit kur nuk janë të mbuluara nga ky paragraf.

17.3.5. Premitë për garat e tjera të reprezentacionit të Kategorisë “A”, pra garat që nuk janë Fed Cup apo Davis Cup, do të caktohen nga Bordi me vendime të veçanta.

17.4. Mëditjet neto për angazhimet e Federatës ofrohen si në vijim:

ANGAZHIMI	MËDITJA
Selektori ¹ / Ekipi ² në gara / kampe të përfaqësueses (jashtë Kosovës)	€60
Trajnerët në kampe përgaditore brenda Kosovës (>3h)	€50
Trajnerët në kampe përgaditore brenda Kosovës (<3h)	€30
Trajner / Ndihmës në kampe të Federatës për fëmijë	€40
Trajner / Shoqërues në kampe jo të Federatës (private)	n/a
Pjesëmarrja në kuvende, konferenca e seminare jashtë vendit	€60
Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës (maksimum 2 në vit)	€50
Mbledhjet e Këshillave / Komisioneve të tjera të Bordit (maks 3 në vit)	€30

1) Përfshinë vetëm selektorët/kapitenët e grupmoshave juniore;

2) Fizioterapeuti, mjeku, shoqëruesi, fotoreporterët, etj. që dërgohen me vendim të Bordit.

18. Regjistrimi i Lojtarëve dhe Afatet Kalimtare

18.1. Një lojtar i cili më herët nuk ka qenë i anëtarësuar në një klub, mund të regjistrohet si anëtar i një klubi në çdo kohë të viti edhe jashtë afatit kalimtar. Lojtari përkatës është i obliguar të plotësoj dokumentacionin (pëlqimin) për regjistrimin si anëtar i klubit përkatës dhe ta dorëzoj në administratën e federatës të nënshkruar, në qoftë se lojtari është i mitur atëherë dokumentin duhet ta nënshkruan prindi i të miturit.

18.2. Kalimi i lojtarit nga klubi në klub bëhet në afatin kalimtar. Afati i parë kalimtar përfshin periudhën para fillimit të sezonës së re të garave 1-31 dhjetor, ndërsa afati i dytë kalimtar hapet gjatë periudhës 1-30 qershor.

18.3. Lojtarët mund të kalojnë nga klubi amë në klubin tjetër vetëm gjatë afatit kalimtar.



-
184. Gjatë procesit të kalimit nga klubi në klub në afatin kalimtar, lojtari duhet të plotësojë dokumentacionin (pëlqimin) dhe ta dorëzojë atë të nënshkruar në administratën e federatës brenda afatit kalimtar, nëse lojtari është i mitur dokumentin duhet ta nënshkruan prindi i të miturit.
 185. Lojtarët kanë të drejtë kurdo gjatë vitit të tërhiqen nga klubi ku bëjnë pjesë, por vazhdojnë garimin në turnet e federatës si lojtarë të pavarur, dhe NUK mund të përfaqësojë një klub tjetër deri në hapjen e afatit kalimtar të radhës bazuar në pikën 18.2 të kësaj rregulloreje. Lojtari mund të garojë si lojtarë i pavarur vetëm nëse ka dorëzuar në federatë kërkesën për të vazhduar garimin si lojtar i pavarur.
 186. Nëse një lojtar deklarohet si lojtar i pavarur jashtë afatit kalimtar, atëherë të gjitha të arriturat e lojtarit përkatës i llogariten klubit amë deri në momentin kur tenisi kalon nëpër procedurat e caktuar gjatë afatit kalimtar të radhës.
 187. Një lojtar ka të drejtë të garojë për një klub tjetër përveç klubit në të cilin është i regjistruar në federatë, VETËM në garat e Kampionatit Ekipor.



19. **Dispozitat përfundimtare dhe të tjera**

19.1. Kjo Rregullore shfuqizon:

- (a) Vendimin e Bordit Nr.2 të datës 19 dhjetor 2016 mbi shpenzimet e tenistëve në Tennis Europe dhe në turnetë nacionale të shteteve (Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, dhe Serbi).
- (b) Vendimin e Bordit Nr.5 të datës 19 dhjetor 2016 mbi pagesat për mbikëqyrësit.
- (c) Vendimin e Bordit Nr. 2019-17 të datës 25 prill 2019 mbi Premitë për Fed Cup dhe Davis Cup; si dhe
- (d) Të gjitha vendimet dhe rregulloret apo dispozitat e rregulloreve të tjera të Federatës që janë në kundërshtim me të.

19.2. Dispozitat e paragrafit 15.2 hyjnë në fuqi vetëm nëse të njëjtat aprovohen nga Kuvendi me buxhetin e vitit 2020.

19.3. Interpretimi përfundimtar i kësaj Rregulloreje është kompetencë e Bordit.

19.4. Kjo Rregullore hyn në fuqi më 17 prill 2024.

Jeton Hadërgjonaj

Kryetar

Federata e Tenisit e Kosovës



Prishtinë, 17 Prill 2024